

NE



TË LIRË

BARAZIA E FËMIJËVE

YLLKA (11), FATIME (11), TUANA B. (11), ART (11), GAZMEND (12), JON (11), LUAN (11)




Ne jemi klasa e VI nga shkolla „Ganimete Tërbeshi“, më poshtë lexoni për demokracinë

Fjala demokraci rrjedh nga greqishtja dhe është një fjalë shumë e vjetër. Demokracia ka lindur në Greqi, në kryeqytetin e saj në Athinë, në vitin 507 para lindjes së Krishtit. Pra, fjala „demos“ në gjuhën shqipe do të thotë popull dhe „kratos“ do të thotë pushtet. Në gjuhën shqipe demokraci do të thotë udhëheqje e një shteti.

Elementet e demokracisë janë: liria, barazia, të drejta të barabarta për të gjithë, toleranca, drejtësia, etj. Ne duhet të jemi të barabartë ndaj njëri-tjetrit. Për shembull, liria nënkupton lirinë e shprehjes së mendimit, lirinë e lëvizjes apo lirinë e zgjedhjes së profesionit. Ndërsa, barazia nënkupton barazinë e të gjithëve pa dallime fetare, racore ose gjinore. Pastaj, toleranca është p.sh., nëse ne japim një mendim dhe një shok apo shoqe tjetër e shpreh një mendim tjetër, ne duhet

të respektojmë dhe tolerojmë mendimin e tyre. Disa nga të drejtat tona janë: e drejta e strehimit, jetesës, ushqimit, e shprehjes së mendimit lirshëm, e drejta që të kemi një emër dhe mbiemër, të shkollohemi, të luajmë etj. Përveç të drejtave kemi edhe përgjegjësi, si p.sh. të mësojmë, të respektojmë rregullat në komunikacion.



Ilustrim i të drejtës së shkollimit



Të drejtat tona nëpër degët e pemës



Grupi i autorëve

ZGJEDHJET, ZEMRA E DEMOKRACISË

DION (11), ELMA (11), ERLETA (11), AJMAN (11), AGON (11), DONJETA (12), RIGON (11)



Zgjedhjet në Kosovë

Nga titulli mund të kuptoni edhe rëndësinë e kësaj teme të mrekullueshme. Pra, siç e kuptuam tema që do t'iu informojmë ne janë zgjedhjet. Ne si fëmijë, fjalën zgjedhje e kuptojmë në disa mënyra. Ne bëjmë zgjedhje në përditshmëri si p.sh. zgjedhjet e robave, e librave të cilat dëshirojmë t'i lexojmë, etj.

Por një lloj të zgjedhjeve që ne si fëmijë (nxënës të klasës së VI-të) e bëjmë dhe që është e përafërt me



Në këtë punim do të informoheni më shumë për zgjedhjet

në këto zgjedhje duhet të jemi mbi moshën 18 vjeçare. Qytetarët e Kosovës, në zgjedhjet qendrore votojnë për deputetët që ndryshe quhen edhe përfaqësues të popullit dhe kanë mandat 4 vjeçar. Ndërsa, në zgjedhjet komunale qytetarët votojnë për kryetarët e komunave si dhe asamleistët.

Ne si nxënës, ju rekomandojmë që të zgjedhni dhe votoni atë që ju mendoni se është më i miri.



zgjedhjet të cilët qytetarët në moshë madhore e bëjnë, janë zgjedhjet që i bëjmë në klasë. Së pari, i propozojmë tre nxënës, pastaj votojmë për atë që mendojmë që është më i miri, për atë rol që e merr.

Të njëjta me këto zgjedhje janë zgjedhjet qendrore (parlamentare) dhe zgjedhjet lokale (komunale), edhe pse këtu nuk kandidojnë vetëm tre kandidatë si në rastin tonë.


Po ashtu, për të pasur mundësinë për të marrë pjesë



Puna e grupit tonë

KOMUNITETI YNË

ADONIS (11), LINOR (11), ELZA (11), EMA (11), SAMET (12), KUJTIM (12), TUANA K. (11), LORINA (11)



Ne si gazetarë të Republikës së Kosovës sot do të flasim për demokracinë dhe për qytetarët aktiv

Ne mësuam se demokracia është pushtet i popullit. Kjo do të thotë se pushtetin në një vend e ka vet populli.

Fjala komunitet do të thotë një grup i njerëzve të cilët kanë interesa të përbashkëta. Ne mësuam edhe për rëndësinë e gjithëpërfshirjes së gjithë qytetarëve të një populli.

Ne përmendëm edhe të drejtat tona, dhe se ne të gjithë duhet të jemi të barabartë. Ne kemi të drejta të ndryshme si të shkollohemi, të mjekohemi, etj. Çdo kush që ka të drejta ka edhe përgjegjësi. Përgjegjësitë janë obligime dhe detyra të cilat kemi ne. Përgjegjësitë tona janë: ta mbrojmë ambientin, të përfundojmë detyrat tona, t'i respektojmë të tjerët, t'i dëgjojmë anëtarët e familjes etj.

Në shkollë ne duhet t'i respektojmë rregullat shkollore dhe duhet që arsimtarët dhe mësuesit t'i konsiderojmë si prindërit tanë.

Në shtëpi duhet t'iu ndihmojmë prindërve, t'i dëgjojmë ata dhe të respektojmë edhe vëllezërit dhe motrat.

Në lagje ne duhet t'i respektojmë banorët e tjerë, t'i përshendesim ata, dhe nëse ata kanë nevojë për ne, ne iu ndihmojmë atyre.


Në shtetin tonë duhet të respektojmë rregullat e komunikacionit, të dalim të votojmë kur t'i bëjmë 18 vjet, pa marrë parasysh nëse jemi vajza apo djem.

Për planetin Tokë, ne mundemi të mos e ndotim ajrin, të mos ndërtojmë fabrika të shumta dhe ta pastrojmë ambientin për të qenë ne fëmijë të shëndetshëm.

Porosia jonë për ju është se ne duhet t'i trajtojmë të tjerët, ashtu siç dëshirojmë të na trajtojnë të tjerët neve.




Qytetarët aktiv të cilët punuam artikullin e gazetës sonë




Të drejtat dhe përgjegjësitë tona



Disa elemente të qytetarisë aktive




Ne të gjithë duhet të votojmë



Shtëpia e qytetarisë aktive



Gjykata punon në mënyrë të pavarur




Kartela identifikuese e gazetarëve të demokracisë



Në demokraci punojmë të gjithë së bashku



Është shumë e rëndësishme të dalim të votojmë



„Demokracia“, më e mira për ne

PUSHTET I NDARË

ALBION (11), ALI (11), ARTA (14), VAJETA (12), ROMESA (11), ERMAL (11), MAJLINDA (11)

Ky artikull i kushtohet ndarjes së pushtetit në një shtet demokratik siç është Republika e Kosovës. Nëse doni të informoheni më shumë për këtë ndarje, mund ta lexoni artikullin më poshtë

Ndarja e pushtetit në një shtet demokratik siç është Republika e Kosovës bëhet në tri degë, ato janë: Pushteti Legjislativ që është Kuvendi, Pushteti Ekzekutiv që është Qeveria, dhe Pushteti Gjyqësor.

Ndarja e pushtetit, bëhet pasi secili prej këtyre institucioneve duhet t'i ketë detyrat e veta. Në Qeveri punojnë Kryeministri, ministrat dhe zëvendësministrat.

Për tu zhvilluar ekonomia e një shteti duhet të hapen vende të reja pune, ku mund të punësohen qytetarët. Qeveria është përgjegjëse për këtë. Ajo mban lidhje të ngushta me Kuvendin dhe me Gjykatën.


Por, të gjitha këto institucione janë të barabarta dhe asnjëra nuk qëndron më lart se tjetra.




Autorët e artikullit



Ky numër që po ngjyrosët nga Arta, tregon se shteti i Kosovës është i ndarë në tre pushtete



Qeveria e ilustruar nga Aliu



Fabrikat janë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik




Albioni dhe Aliu duke punuar për artikull

Kuvendi është një institucion shumë i rëndësishëm për një shtet demokratik. Kuvendi ka shumë detyra. Në Kuvend miratohen ligjet, po ashtu ai përfaqëson shtetin dhe popullin, si dhe ai shfuqizon dhe propozon ligje. Kuvendi e zgjedh dhe e kontrollon Qeverinë ose punët që bën Qeveria. Në Kuvend zgjedhet edhe Presidenti me anë të votave të deputetëve.


Në shtëpinë e popullit nuk lejohet që të hyjnë të gjithë njerëzit pa autorizim, por vetëm deputetët, Kryetari apo gazetarët të cilët kanë autorizim për të hyrë, po ashtu edhe Presidenti, Kryeministri, ministrat etj.



Arta, Valjeta dhe Romesa duke shkruar për Kuvendin



Kuvendi i ilustruar nga Valjeta



Kuvendi miraton, shfuqizon dhe propozon ligje

Gjykata është një institucion i rëndësishëm i shtetit demokratik. Ajo ndahet në Gjykatën Themelore, Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme. Në sistemin gjyqësor punojnë gjykatësit, prokurorët, avokatët, etj. Gjykata bashkëpunon me Qeverinë dhe Kuvendin. Në gjykatë shkojnë ata të cilët janë të dyshuar për kryerjen e veprave penale. Në qoftë se gjykata ka dëshmi të plota, ajo ka të drejtë të jap dënim për të pandehurin. Po të mos ishte Qeveria dhe Kuvendi nuk do të kishte as gjykata.

Ne kemi ardhur në përfundimin se gjykata është shumë e rëndësishme për një shtet, ashtu siç janë edhe Kuvendi dhe Qeveria.



Ermali dhe Majlinda duke shkruar për gjykatat



Gjykata Supreme e ilustruar nga Ermali



Drejtësia nga gjykatësi



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Ganimete Gërbeshi“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VI-1
Website: www.demos-ti.org Vendi: Llukar